

Bashkëveprimi gazetar-pronar në kulturën e gazetarisë shqiptare

Jonila Godole*

Hyrje

Punimi i mëposhtëm synon të analizojë marrëdhënien e gazetarëve dhe pronarëve të medias në Shqipëri, teorikisht dhe në mënyrë empirike. Teza kryesore e punimit është se si gazetarët ashtu edhe pronarët e medias duhen trajtuar si aktorë me interesa të ngushta vetjake, të cilët priren nga këto interesa dhe e ndërtojnë marrëdhënien e tyre në bazë të përmbushjes apo jo të tyre. Sepse gazetarët nuk punojnë në vakuum. Gjatë aktivitetit që ushtrojnë ata ndeshen me pengesa dhe ndikime, të cilat kanë impakt të ndryshëm mbi produktin apo formatin që ata i prezantojnë audiencës¹. Këto ndikime mund të jenë të dukshme përmes kodeve etike por edhe të padukshme brenda redaksisë, si censura dhe etosi profesional.

Pa harruar ndikimin që mund t'u vijë nga audiencat, burimet dhe afatet edorëzimit të produkteve të përfunduara, sepse siç thotë McQuail, "përmbajtja influencohet sistematikisht dhe dukshëm nga rutinat organizative, praktikat dhe synimet më shumë se sa nga faktorë personalë apo ideologjikë"². Pra, nëse dikur gjatë sistemit komunist, gazetarët kishin një sërë pengesash tipike për sistemet totalitare, sot këto janë të një natyre tjetër.

Si pikënisje për këtë artikull ishin të dhënat që u përfatuan nga një anketim i gjerë me gazetarët shqiptarë (population = 295) në 8 qytete të vendit më 2012, në kuadër të studimit ndërkombëtar për kulturat e

* Dr. Jonila Godole, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit Universiteti i Tiranës.

¹ McQuail, Denis. 2000. *Mass Communication Theory*. New York: SAGE Publications, f. 244.

² Po aty.

gazetarisë "Worlds of Journalism Study"³. Për të evidentuar nga afër se cilët janë këta faktorë që ndikojnë mbi gazetarët shqiptarë, gjatë anketimit ata u pyetën se si e vlerësonin ndikimin e një sërë burimesh të ndryshme që iu paraqitën përmes një shkalle matëse nga 1 te 5, ku 1 nënkupton që nuk ndikon fare dhe 5, që ndikon jashtëzakonisht.

Gazetari si një aktor: Pritshmëritë

Kur flasim për "aktorët" në gazetari nuk mund të lëmë pa sqaruar terminologjinë përkatëse. Pritshmëria e publikut për gazetarin është ta shoh atë në rolin e *homo sociologicus*⁴, të informojë saktë dhe shpejtë, në mënyrë të paanshme⁵. Ndërkohë që çdo gazetar (si pjesë përbërëse e një kolektivi) vepron nën trysni të ndryshme, sa i ndikuar nga interesat komerciale të medias ku punon (indirekt dhe nga audiencat), aq edhe nga interesat personalë: të maksimizojë kapitalin social dhe financiar – si *homo economicus*. Kjo logjikë duket qartë në mënyrën se si ndodh socializimi brenda redaksisë. Një gazetar i sapodiplomuar që afrohet pranë një kompanie mediatike dhe "thyen" parimet e mësuara në teori, ka dy rrugë: të përballet drejtpërdrejt me problemin (konflikt!), ose të përshtatet (dhuna e kolektivit!).

Ky bashkëveprim i individit me kolektivin, ndodh përmes "rregullash" dhe "detyrimesh" të shkruara apo të pashkruara, të cilat janë përcaktuese për sjelljen e tij të mëtejshme brenda atij mjedisi profesional. Sa më shumë "përfitim" të shohë secili aktor në bashkëveprim, aq më mirë funksionon socializimi, pra futja në "kallëp". Me fjalë të tjera, procesi socializues prodhon konformitet! Një gazetar mund të jetë i kënaqur me rrogë më të ulët, për sa kohë ka një vend pune të sigurt. Kjo gjendje e kënaq si atë, ashtu edhe

³ Worlds of Journalism Study (WJS) drejtuar nga prof. Thomas Hanitzsch (2007). Shiko më tej: <http://www.worldsofjournalism.org>

⁴Schimank, Uwe. 2005. *Differenzierung und Integration der modernen Gesellschaft: Beiträge zur akteurzentrierten Differenzierungstheorie*. Wiesbaden: VS-Verlag, 37-121.

⁵ Në fakt edhe pronari apo drejtuesit editorialë të gazetës kanë pritshmëri të ngjashme ndaj gazetarit, ata duan që ai të sillet konform rregullave të vendosura duke i zbatuar ato.

pronarin e kompanisë mediatike. Shembujt nga realiteti, na tregojnë se *harmonia* priset kur njëri aktor kërkon të përfitojë në kurriz të tjetrit. Mosgjetja e kompromisit mund të sjellë konflikt, por edhe zgjidhje radikale.⁶ Në këtë rast ndërhyrja nga jashtë (institucionale, përmes rregullave, kodeve, të vendosura dhe të pranuar nga të gjithë) mbetet e vetmja zgjidhje.

Kjo ndërmarrëdhënie forcash në *biotopin* e përgjithshëm bën që gazetarët të jenë të kujdesshëm në praktikat profesionale të përditshme. Nga njëra anë ata reklamojnë “zyrtarisht” parimet normative të gazetarisë (për shembull, në rastin kur pyeten për rolin dhe funksionin e gazetarisë në shoqëri), dhe nga ana tjetër ndjekin *doksën gazetareske* (reale) që mbizotëron në habitatin e tyre: pra, praktikat e dukshme dhe të padukshme që ndiqen nga të gjithë.

Tipologjia e pronarit të medias


Duke u mbështetur te tipologjia aktoriale e Schimank më sipër, gazetarin mund ta shohim si një aktor që përballet me ndërvarësi sociale, të cilat mund të jenë simetrike ose asimetrike⁷. Me asimetri nënkuptohet që aktorët të mos jenë shumë të varur nga njëri-tjetri, por të kenë më shumë liri veprimi dhe vendimmarrjeje. Kur ndërvarësia mes gazetarëve dhe pronarit të medias p.sh është asimetrike sjell detyrimisht konfliktin. Por, si gazetari, ashtu edhe pronari i një medie janë aktorë socialë që luajnë një rol të caktuar në shoqëri. Pronari i një medie mundëson botimin e një gazete ose mediumi, punëson gazetarë dhe ofron një produkt: një gazetë, revistë, TV, radio etj. Ky produkt

⁶ Zgjidhja radikale mund të ishte si në rastin e stafit të një prej gazetave më të mëdha në Shqipëri, “Shekulli”, në pranverë 2012, që u vetëlargua nga puna duke shkaktuar mosbotimin e gazetës, sepse nuk e kishin marrë rrogën prej disa muajsh. Herët e tjera që kishte ndodhur një situatë e ngjashme, një nga anëtarët e kolektivit kishte gjetur një kompromis me botuesin duke bërë që dikur i tërë kolektivi të kthehej në punë. Në rastin e fundit, kolektivi qëndroi i vendosur dhe botuesi, i cili nuk pranoi të bënte kompromis, zuri postin e kryeredaktorit dhe gazetarit të vetëm të redaksisë.

⁷Schimank, Uwe. 2000. *Handeln und Strukturen: Einführung in die akteurtheoretische Soziologie*. Bünden: JUVENTA, f. 83.

nga ana tjetër i mundëson atij audiencë, pjesëmarrje në debatin publik. Si aktor ai ndjek qëllimet e veta, të cilat nuk mund të reduktohen vetëm te fitimi sepse nëse do të mjaftonte një analizë lineare, paksa e reduktuar e pronarit, do të thoshim se pronari vepron si “homo economicus”, por edhe si “homo sociologicus”.

Figura 1. Pritshmëritë e aktorëve, të pronarit dhe gazetarit



Deri tani në Shqipëri, marrëdhënia gazetar - pronar është trajtuar si konfliktuale, ku konflikti konsistonte në modelin që ne kemi krijuar për gazetarinë dhe rolin e gazetarit. Pra, kritikë e bazuar në një qasje normative, ku pritshmëritë e çdo aktori rregullohen sipas “kallëpeve” shoqërore të formësuara qoftë prej ligjeve të miratuara, ashtu edhe nga aspekte të tjera kulturore dhe historike. Qasja që duhet aplikuar është një e ndryshme: Pronari dhe gazetari duhen trajtuar si aktorë ndërveprues (Fig. 1). Pronari ndjek synimet e tij, i orientuar drejt fitimit (kalkulimi kosto-përfitim) dhe gazetari ndjek po ashtu synimet e tij i orientuar drejt përfitimit (kapital social, simbolik, financiar etj). Dhe mbi të gjitha, të dy aktorët lëvizin në një hapësirë dhe treg të vogël siç është Shqipëria.

Rezultati i veprimeve të një aktori është përherë i rrezikuar nga veprimet e aktorëve të tjerë. Që një pronar të dojë të vendosë veton dhe t’i përdorë gazetarët si “postierë” të letërkëmbimit të tij personal me politikanë dhe aktorë të tjerë, këtë ai mund ta justifikojë me


përfitimet e tija personale. Por kjo nuk do të thotë se gazetarët që e njohin funksionin dhe rolin që mban para publikut dhe aktorëve të tjerë, t'i binden dhe për më tepër që kuadri ligjor duhet ta miratojë këtë akt. Mosbindja e gazetarëve nuk është antagonizëm, por një ndjekje rigoroze e interesit të tyre personal. Sa më të ndërgjegjshëm të jenë ata për rolin e tyre, aq më shumë do të ushtrojnë pushtet dhe presion, aq më shumë rritet mundësia e tyre për grumbullim të kapitalit social dhe simbolik. Të dyja palët sidoqoftë vijnë të ngarkuara në përballjen e tyre përse i përket trashëgimisë që bartin në kujtesën e tyre individuale por edhe kolektive: a) *pronari gjatë komunizmit ishte shteti, i cili kishte kontroll të padiskutueshëm mbi median dhe në rast mosbindjeje mund të përdorte represionin; b) gazetari ishte nën shërbim të shtetit dhe konform rregullave.*

Në kujtesën kulturore të pronarit të sotëm, varësia e medias nga “pronari” (shteti) mund të zgjojë ndjenjën e konformitetit për arsye mbijetese (dhe lehtësie)! Sepse siç thotë Goffman, kush nuk është në gjendje t'i përshtatet “skemës”, është jofunksional si aktor⁸. Kështu figurën e mësipërme mund ta modifikojmë duke treguar ndikimin që e kaluara ka mbi aktorët e fushës së gazetarisë dhe njëherazi edhe mbi pritshmëritë e tyre. Nga përplasja e pritshmërive të aktorëve, pra nga konflikti, buron konsensusi që në vetvete nënkupton reduktim të “hapësirës përfituese” personale kundrejt tjetrit.

Në figurën 2, shohim ndikimet mbi aktorët e fushës së medias nga e shkuara (ethosi profesional) dhe nga e sotmja (konkurrentët, kolegët, kuadri ligjor, por edhe familja, rrethi shoqëror etj). Kështu që secili nga aktorët e mësipërm nuk është thjesht një individ ose një kolektiv, por një zinxhir reaksionesh dhe pritshmërish të vetat dhe të të tjerëve. Kështu që aktorët veprojnë vazhdimisht në shkëmbimin mes “role making” (përmbushja e rolit) dhe “role taking” (përmbushja e pritshmërive të individëve apo grupeve sociale, kolektivit).

⁸Goffman, Erving. 1990/1959. *The presentation of self in everyday life*. London: Penguin books.

Figura 2. Pritshmëritë e aktorëve në ndikimin e të shkuarës dhe të tësotmes



Gjatë regjimit komunist gazetarët ishin në funksionin e të marrurit apo të veshurit të një roli (role taking), i cili përcaktohej qartë nga shteti (propagandues). Sot ata ndodhen në dilemën mes “role taking” dhe “role making”. Gazetarët që mbajnë rangje të larta në hierarkinë profesionale e kanë më të lehtë të ushtrojnë “role making” sesa reporterët që fillojnë punë në moshë të re, për shembull. Megjithatë kjo nuk i përjashton as drejtuesit, kryeredaktorët etj., nga konflikte të ndryshme për sa i përket rolit të tyre.

Pra, mund të themi se si gazetarët, ashtu edhe pronarët e medias në Shqipëri, vuajnë nga “racionaliteti i kufizuar”, ose mungesa e racionalitetit, i cili bën që problemet të rriten dhe të shkojnë drejt pazgjidhshmërisë ose zgjidhjeve radikale. Siç e shohim në të dyja skemat, aktorët janë të varur nga pritshmëritë e njëri-tjetrit. Pronari duhet të njohë pritshmëritë e gazetarëve, punonjësve, partnerëve të

biznesit, politikanëve, rrethit shoqëror, konkurrentëve, institucioneve monitoruese të medias, kuadrin ligjor etj. Po ashtu gazetari duhet të njohë pritshmëritë e pronarit, të kuadrin ligjor, të politikës, të rrethit shoqëror dhe familjes, kolegëve në median e tij apo në mediat e tjera, të institucioneve që monitorojnë median etj. Si gazetari, ashtu edhe pronari kthehen në bartës të reaksioneve zinxhir të pritshmërive personale ndaj vetes dhe të të tjerëve ndaj tij. Konflikti mes tyre mbetet sidoqoftë i fshehur, latent, po t'i referohemi "kujtesës historike" që rëndon mbi modelin e marrëdhënieve të këtyre dy aktorë në Shqipëri dhe i fut ata jo rrallë në një konflikt rolesh që pasohet nga një krizë legjitimimi përballë njëri-tjetrit. Cila është zgjidhja për këtë krizë? Sipas Schimank, aktorët duhet të përcaktojnë qartë rolet e tyre⁹. Për këtë, secilit i nevojten burime të mjaftueshme dhe, roli i secilit duhet të përputhet me perceptimin dhe pritshmëritë e tyre. "Presioni i pritshmërisë është vendimtar për të shpjeguar konfliktet mes roleve të ndërvarura"¹⁰.

Jemi mësuar zakonisht që gjendjen e gazetarisë në Shqipëri ta shohim të reduktuar në një marrëdhënie shkak-pasojë, ku gazetarët vuajnë nën pronësinë dhe politikën (përmes pushtetit të favorizimit). Siç u përpoqëm të sqarojmë deri më tani, strukturat shoqërore ndikojnë nga njëra anë mbi sjelljet e aktorëve, përfshi këtu motivet, format shprehëse të veprimeve të tyre. Dhe nga ana tjetër, veprimet e aktorëve ndikojnë mbi strukturën shoqërore duke krijuar pritshmëri, perceptime dhe njësi vlerash të caktuara.

Pyetjet kërkimore

Ky punim analizon marrëdhënien mes gazetarëve dhe pronarëve të medias shqiptare. Bazuar në pjesën teorike, synimi është të zbulojmë në ç'mënyrë funksionon kjo marrëdhënie. Teza kryesore e punimit ishte se gazetarët dhe pronarët e medias duhen trajtuar si aktorë me interesa të ngushta vetjake, të cilët priren nga këto interesa dhe e

⁹Schimank, Uwe. 2000. *Handeln und Strukturen: Einführung in die akteurtheoretische Soziologie*. Bünden: JUVENTA, f. 55.

¹⁰Po aty, f. 56.

ndërtojnë marrëdhënien e tyre në bazë të përmbushjes apo jo të tyre. Duke pasur parasysh të dhënat empirike mund të shtrojmë këto pyetje kërkimore: A ndikohen gazetarët nga pronarët e medias? Si e perceptojnë ata këtë ndikim, nëse ka? A ka ndryshime në këtë perceptim në varësi të hierarkisë së gazetarëve?

Metodologjia

Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve ky studim analizon të dhëna nga një anketë e kryer në tetë qytete në Shqipëri¹¹. Gazetarët e intervistuar (295) ishin përzgjedhur nga çdo redaksi lajmesh, duke përfaqësuar tre nivele hierarike: reporterë (niveli jo menaxhial), zëvendësredaktorë (niveli i mesëm menaxhial) dhe drejtorë apo kryeredaktorë (niveli i lartë menaxhial). Kompanitë mediatike u përzgjedhën në mënyrë të tillë që të përfaqësonin gjerësisht sistemin medatik shqiptar, duke përfshirë media kombëtare dhe lokale. Mediat transmetuese u përzgjedhën në bazë të kritereve të pronësisë: publike dhe private. Mediat argëtuese (si Radio DJ) dhe formate të tjera që nuk kanë të bëjnë me përpunimin e përditshëm të informacionit nuk u përfshinë në anketë. Sondazhi u krye plotësisht i standardizuar, ballë për ballë (92%), me telefon (7%) ose përmes internetit (1%).

Ndër të tjera, të anketuarit u pyetën për të vlerësuar ndikimin e burimeve të ndryshme duke iu ofruar pesë alternativa nga 1 në 5, ku 1 do të thotë jo me ndikim dhe 5 jashtëzakonisht me ndikim. Së fundi, për të kuptuar më mirë të dhënat e studimit, u desh të kryheshin intervistat në thellësi me gazetarë me përvojë në mënyrë që të përftohej një panoramë më e qartë e marrëdhënies pronar-gazetar.

Rezultatet


Burimet influencuese mbi gazetarët

Gazetarët e pyetur në anketë për ndikimet mbi gazetarët nga brenda redaksisë ofruan përgjigje të cilat mund t'i përmbledhim në katër dimensione kryesore: *ndikimin nga politika editoriale që vlerësohet nga*

¹¹Godole, Jonila. 2014. *Gazetaria shqiptare në tranzicion*. Tiranë: Papirus.

mbi gjysma e gazetarëve të pyetur (53%), ndikimin nga niveli drejtues editorial (43%), ndikimin që vjen nga pronarët e medias (39%) si dhe ndikimin nga niveli i lartë menaxherial i medias (drejtor i përgjithshëm etj).

Grafiku 1: Faktorë ndikues të strukturës redaksionale (% e përgjigjeve “ ndikon shumë” dhe “ jashtëzakonisht”)



Pronarët e kompanive mediatike renditen për nga ndikimi që kanë menjëherë pas kryeredaktorëve, dhe jo përpara tyre. Disa nga përgjigjet e gazetarëve duken në pamje të parë kundërthënëse me njëra-tjetrën. Kështu, nëse më sipër pamë se politika (përmes politikanëve dhe zyrtarëve të shtetit) nuk vlerësohet si një burim influencues shumë i madh nga ana e gazetarëve, këtu na bie në sy që “vija editoriale” e medias paska një ndikim relativisht të lartë mbi ta. Që nënkupton natyrisht politikën që ndjekin botuesit e medias, por indirekt edhe ndikimin e politikës mbi ta. Kjo ndërhyrje është mjaft më e lartë se “pronarët e medias si burim influence” në vetvete për shembull, dhe që na kujton sërish se përgjigjet e gazetarëve për pyetje direkte jo gjithmonë përputhen me ato që ata mendojnë siç dëshmojnë interpretimet e kryqëzuara të rezultateve që prezantohen në këto tabela.

Perceptimi i ndikimeve nga gazetarët me përvojë

Një tjetër panoramë na paraqitet kur pyesim gazetarët e vjetër shqiptarë. Sipas perceptimit të tyre ndikimin e pronarëve mbi gazetarët mund ta operacionalizojmë kryesisht në tri dimensione: ndërhyrjen mbi stafin për arsye të përkrahjes politike, ndërhyrjen për arsye të përfitimit vetjak ekonomik apo ndërhyrjen për shantazh ndaj kundërshtarëve të biznesit dhe politikës në përgjithësi.

Kështu, Ilva Tare thotë se gazetaria si dje, ashtu edhe sot, rrezikon vazhdimisht të jetë një vegël e përdorshme nga duart e pronarëve të medias, nga pushteti politik¹².

Të njëjtën logjikë ndjek edhe Alba Malltezi kur shprehet se roli i gazetarisë është seriozisht i dëmtuar nga mbizotërimi i mediave-vegël në duar të disa pronarëve që kanë si synim parësor shtimin e pasurisë personale dhe mbrojtjen e aktiviteteve të tjera ekonomike¹³.

Rezear Xhaxhiu shkon më tej duke e quajtur median "një kobure të ndryshkur në duart e tyre"¹⁴. Përsa i përket mënyrës se si pronarët ndikojnë mbi gazetarët, Çipa flet për një dominim të tyre ndaj gazetarëve me anë të telefonit apo prezencës fizike në redaksi¹⁵. Por në mënyrë të veçantë ajo që quhet plaga e gazetarisë shqiptare është ndikimi i politikës në media përmes pronarëve.

Ky ndikim sipas ish gazetarit Alfred Peza duket kryesisht në unifikimin e pronësisë së medias me postet editoriale që tregon lidhjen e ngushtë të medias me politikën në Shqipëri. "Pronarëve nuk u mjafton të jenë pronarë, por duan të bëjnë vetë edhe lidhjen e shkurtër me politikën, pa ndërmjetësimin e gazetarit. Nga ky problem derivojnë gjithë problemet e tjera". Po si bëhet kjo lidhje e shkurtër? Në përgjithësi përmes popullimit të posteve drejtuese dhe

¹²Ilva Tare, gazetare, moderatore e emisionit "Tonight Ilva Tare" në TV Ora News, Intervistë, Tiranë, 2012.

¹³ Intervistë e autores me drejtoreshën e gazetës "Shqiptarja.com", Alba Malltezi, 2012.

¹⁴ Intervistë me moderatorin Rezear Xhaxhiu, 2012.

¹⁵ Intervistë me kryetarin e Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, Aleksandër Çipa, 2012.

menaxheriale të mediave me persona që i përkasin rrethit të afërt miqësor të pronarëve, ose në rastin më të mirë janë familjarë të tyre¹⁶.

Përfundime

Si përfundim mund të themi se marrëdhënia mes gazetarit dhe pronarit të medias është e dyanshme. Nëse sot mund të themi se "Qeni i rojës së demokracisë është kthyer në qen roje të pronarit të medias!" kjo ka ndodhur në mirëkuptim të plotë të palëve. Gazetari zgjedh një rol i orientuar drejt përfitimeve të tij (të momentit, ose afatgjata). Militantizmi ndaj një partie, apo interesave të pronarit të medias etiketohet nga Aleksandër Furxhi si "komardare sigurie për gazetarët që punojnë për interesa të caktuara politike apo biznesi"¹⁷. Nga ana tjetër, politizimi i gazetarëve dhe marrëdhënia e tyre me politikën duket qartë në dëshirën e gazetarëve shqiptarë për të pasur pushtet (politik). Në këtë pikë, gazetari përafrohet me politikën dhe politikanin. Për rrjedhojë, gazetari nuk mund ta mbajë atë distancë që është e rekomandueshme mes medias dhe politikës:

"Sot, gazetarët përpara ekranit ku shkruajnë lajmin u del fytyra e pronarit dhe interesat që ai ka në biznes dhe politikë. Nëse lajmi në fjalë lidhet me ndonjë prej tyre, hyn në lojë vetëcensura. Prandaj lajmet janë kthyer në një paradë arritjesh dhe suksesesh ose në një pasqyrë e pa thelluar dhe argumentuar situatën [...]".¹⁸

¹⁶Në momentin e intervistës (qershor 2012), Alfred Peza ishte drejtor i TV Vizion +, ndërsa aktualisht është deputet i PS në parlamentin e përfutur pas zgjedhjeve elektorale të 23 qershorit 2013.

¹⁷ Aleksandër Furxhi, gazetar, moderator i emisionit "Prizëm", TV Albanian Screen, Intervistë, Tiranë, 21 Nëntor 2012.

¹⁸ Ilva Tare, gazetare, moderatore e emisionit "Tonight Ilva Tare" në TV Ora News, Intervistë, Tiranë, 26 Tetor 2012.

Bibliografia

Godole, Jonila. *Gazetaria shqiptare në tranzicion*. Tiranë: Papirus. 2014.

Goffman, Erving. *The presentation of self in everyday life*. London: Penguin books.

Hanitzsch, Thomas. "Deconstructing Journalism Culture: Toward a universal Theory". In: *Communication Theory* (17). 2007. (367-385).

McQuail, Denis. *Mass Communication Theory*. New York: SAGE Publications. 2000.
1990/1959.

Schimank, Uwe. *Handeln und Strukturen: Einführung in die akteurtheoretische Soziologie*. Bündingen: JUVENTA. 2000.

Schimank, Uwe. *Differenzierung und Integration der modernen Gesellschaft: Beiträge zur akteurzentrierten Differenzierungstheorie*. Wiesbaden: VS-Verlag. 2005.